



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 286/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziq dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Lipjan paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të vendosjes së posterave në objektin publik, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1100 (njëmijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### **Arsyetim**

Me datën 21.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se me datën 19.10.2013, rreth orës 14:00, në fshatin Kraisht-Lipjan anëtarë të PDK-së, kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune, në shkollën fillore "Skenderbeu" ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës janë shkelur neni 33 pika b e LZP-se dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, neni 3 pika b.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi, për shkeljen e pretenduar.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013 në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga PDK, në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së janë pabaza pretendimet e LVV-së lidhur me shkeljet e pretenduara. Ata shtuan se Ankesë e njëjtë është ushtruar edhe më herët për kohën dhe vendin e njëjtë, të cilën e kemi kundërshtuar me faktin se posteri i tillë është vendosur gjatë një takimi elektorale dhe se i njëjti është hequr me të përfunduar ai takim.

PDK i propozon PZAP-it që të hedhë poshtë pretendimet e LVV-së

Bashkangjitur më përgjigjen në ankesë PDK, ka dërguar edhe foto për heqjen e posterave në shenjat publike.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Sepse me datën 19.10.2013, rreth ores 14:00, në fshatin Kraisht-Lipjan anëtarë të PDK-së, kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune, në shkollën fillore "Skenderbeu" ku me këtë veprim janë shkelur neni 33 pika b e LZP-se dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, neni 3 pika b.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografitë e ofruara si provë, nga parashtruesi i ankesës, të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se posterin e kandidatit për kryetar komune nga radhët e PDK-së, është i vendosur në objektin publik të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se PDK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se posterat e kandidatit për kryetar komune në Lipjan kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë postrerin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Andaj PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e PDK-së është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe neni 33 pika b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit për kryetar të komunës të PDK-së janë vendosur mbi rrugët publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik PDK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, neni 120 paragrafi 1 pika c), si dhe neni 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në Prishtinë**

Anr. 286/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit**

**Nehat Idrizi**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.